



## KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Lutfiu" Nr.93 10000 Prishtinë  
Tel: +381 (0) 38 247-587 / +377 (0) 44 636-359  
Web: [www.kolegjidardania.com](http://www.kolegjidardania.com)

Në pajtim me nenet 17, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe nenet 63, 64, dhe 76 të Statutit të Kolegjit Dardania në Prishtinë; në mbledhjen e Këshillit Drejtues të Kolegjit Dardania të datës 21.10.2024 miratohet

### KODI ETIK I KOLEGJIT DARDANIA

Kodi Etik i Kolegjit Dardania përmban parimet themelore të etikës profesionale me të cilat udhëhiqen: stafi akademik, studentët dhe administrata për shërbime studentore.

#### Neni 1

Kodi Etik i Kolegjit përbëhet nga standardet e sjelljes të stafit akademik ku merret parasysh parimet e lirisë, të krijimtarisë shkencore dhe të punës praktike.

#### Neni 2

### QËLLIMI

Qëllimi i Kodit Etik është që të mbrojtë lirinë akademike të anëtarëve të komunitetit të Kolegjit Dardania duke iu mundësuar atyre standarde të larta për mësim, hulumtime shkencore, punë praktike dhe shërbime studentore.

Kodi Etik përcakton standarde themelore të sjelljes etike që konsiston në marrëdhënie të mira ndër personale për tërë komunitetin e Kolegjit Dardania.

Kodi Etik synon të përforcojë mirëbesimin, besnikërinë dhe përkushtimin në mesin e anëtarëve të komunitetit të Kolegjit dhe të sigurojë transparencën dhe përgjegjësinë shoqërore të aktiviteteve të Kolegjit.

Kodi Etik ka për qëllim të inkurajojë autonominë e mësimdhënies dhe nxënitis si dhe lirinë e hulumtimit shkencor me qëllim që të promovojë imazh pozitiv të Kolegjit.

Kodi Etik i Kolegjit Dardania zbatohet përmes proceseve dhe mekanizmave të qarta, për të gjithë stafin, studentët dhe personelin tjetër në njësitë strukturore të Kolegjit.

### **Neni 3**

#### **Definimet**

Kodi Etik përmban disa definime specifike të cilat duhet kuptuar si në vijim:

Stafi akademik, studentët dhe administrata për shërbime studentore janë të përkushtuar që me sinqeritet dhe me përgjegjshmëri të mbajnë qëndrim të drejtë, të kenë mendim kritik dhe tolerancë në përditshmërinë praktike me qëllim të përmbushjes së detyrave të punës duke mundësuar kështu ruajtjen e integritetin e tyre personal dhe kolektiv,

- **Komunitetet e Kolegjit** - nënkupton të gjitha subjektet të cilat studiojnë, mbajnë mësim, merren me hulumtime, ofrojnë shërbime apo përkujdesen për cilësinë e punës në Kolegjin Dardania.
- **Bashkësia e Kolegjit** - nënkupton numrin e gjithmbarshëm të anëtarëve të bashkësisë të Kolegjit.
- **Anëtarët e bashkësisë akademike** - nënkupton të gjithë personat të cilët marrin pjesë në procesin arsimor, në punën kërkimore-shkencore, dhe në punën mentoriale me studentë.
- **Mësimdhënës**-përmban të gjitha subjektet të cilët mbajnë mësim në Kolegj, pavarësisht statusit të tyre të punës (të rregullt, bashkëpunëtorë me kohë të pjesshme, apo si bashkë mentorë të mësimit praktik).
- **Studentë** - nënkupton të gjithë personat të cilët janë regjistruar dhe i përcjellin ligjëratat, ushtrimet, punën praktike, në programet e ndryshme të Kolegjit Dardania.

Emërtimet e subjekteve të përdorura në këtë kod etik kanë kuptimin e të dy gjinive pa paragjykim.

### **Neni 4**

#### **Shkurtesat**

**KE - Këshilli i Etikës**

**PE - Procedura Etike**

**KD- Kolegji Dardania**

**PA - Personeli Akademik**

**ST - Studentët**

### **Neni 5**

#### **Misioni dhe vlerat e Kolegjit Dardania**

Kolegji Dardania është institucion privat që ofron arsim cilësorë në fushat e shkencave sociale, ekonomike, dhe psikologji duke ofruar zhvillim profesional dhe aftësim praktik që kontribuon në ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë.

Nëpërmjet mësimdhënies, hulumtimit shkencor dhe aftësimit praktik, Kolegji ngritë staf të kualifikuar dhe të aftë profesionalisht për të kontribuar në avancimin e politikave publike, zhvillimin ekonomik dhe rritjen e cilësisë së jetës sociale dhe kulturore në Kosovë.

Kolegji Dardania ofron studime ndërdisiplinore të cilat i avancojnë njohuritë e studentëve duke i aftësuar për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Si pjesë e Zonës Evropiane të arsimit të lartë, Kolegji implemton në programet e veta standardet e përbashkëta të Deklaratës së Bolonjës, duke promovuar bashkëpunim intensiv me institucionet e arsimit të lartë në Komunitetin Evropian dhe më gjerë.

#### **Neni 6**

Anëtarët e komunitetit (mësimdhënësit, hulumtuesit, studentët dhe stafi administrativ) të Kolegjit Dardania e mbështesin misionin e Kolegjit duke kryer në mënyrë të plotë dhe permanente aktivitetet e tyre, duke marrë pjesë në mënyrë të përgjegjshme në organet përkatëse dhe duke vepruar në përputhje me vlerat themelore të Kolegjit.

#### **Neni 7**

Vlerat bazë mbi të cilat mbështetet Kolegji Dardania përfshijnë përsosmërinë, ndershmërinë, autonominë si dhe lirinë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor. Këto parime garantojnë respektimin e integritetit personal, nxisin marrëdhënie njerëzore të humanizuara dhe afirmojnë drejtësinë, barazinë dhe të vërtetën si vlerën më të lartë.

Kolegji Dardania stafit akademik, studentëve dhe administratës iu mundëson që punën e tyre ta kryejnë me integritet, përgjegjshmëri, qëndrim kritik, tolerancë dhe sinqeritet.

#### **Neni 8**

### **ZBATIMI**

Kodi etik i Kolegjit Dardania të gjithë anëtarëve të komunitetit iu siguron të drejtat të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe me rregulloret përkatëse. Ky Kod i Etikës aplikohet për:

- a) stafin akademik (asistentët, ligjëruesit, profesorët asistentë, profesorët e Asociuar, profesorët e rregullt, si dhe bashkëpunëtorët e jashtëm);
- b) studentët (studentët e nivelit BA, MA, Alumni);
- c) personelin në administratë, dhe
- d) punëdhënësit me të cilët bashkëpunon Kolegji Dardania.

## Neni 9

### PARIMET E PËRGJITHSHME

Kodi etik i Kolegjit Dardania mbështetet në parimet themelore si:

- 4.1. **Parimi i respektimit të integritetit** të individit dhe të bashkësisë në përputhshmëri me të drejtat e garantuara për jetë, integritet dhe dinjitet. Integriteti i mësimit, hulumtuesit dhe studentëve të Kolegjit Dardania shprehet nëpërmjet sjelljes etike brenda dhe jashtë mjedisit të tij.
- 4.2. **Parimi i privatësisë** me të cilin garantohet e drejta për jetë, integritet dhe në privatësi.
- 4.3. **Parimi të drejtës së bashkësisë** për të vepruar në mënyrë autonome në kufijtë e statusit të vet dhe në përputhje me qëllimet e Kolegjit.
- 4.4. **Parimi për zhvillim dhe përsosje të vazhdueshme profesionale** i cili konsiston në të drejtën e të gjithë anëtarëve të bashkësisë për tu zhvilluar profesionalisht dhe përsosur gjatë gjithë jetës, konform mundësive dhe planeve personale duke mos rrezikuar të tjerët.
- 4.5. **Parimi i përgjegjësisë** që nënkupton se të gjithë anëtarët e bashkësisë të kolegjit kanë detyrë që ndaj të tjerëve të kenë sjellje të ndershme, sinqertë dhe të paanshme.
- 4.6. **Parimi i barazisë** i cili nënkupton sigurimin e kushteve të njëjta dhe të barabarta për përmbushjen e detyrave profesionale, shprehjen e aftësive intelektuale dhe të avancimit profesional.
- 4.7. **Parimi i të drejtës në lirinë akademike**, që nënkupton se të gjithë anëtarët e bashkësisë akademike në hulumtimet e tyre duhet të udhëhiqen me idenë e lirisë të krijimtarisë shkencore dhe shprehjes së lirë duke qenë në kërkim të vërtetës.
- 4.8. **Parimi i përkushtimit dhe besnikërisë** që nënkupton se anëtarët e komunitetit të Kolegjit përkushtohen fort dhe shprehin besnikërinë e tyre në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisë të punës në kuadër të Kolegjit Dardania dhe jashtë tij, për të zbatimin, ruajtjen dhe ruajtjen së vlerave themelore të tij.

## Neni 10

### VEPRIMET JOETIKE

Kodi etik i Kolegjit Dardania synon parandalimin e veprimeve jo etike si:

- 10.1. **Diskriminimi**- që nënkupton ushtrimin e çfarëdo veprimi të vetëdijshëm apo të pavetëdijshëm kur individë ose grupe të caktuara sociale (studentë, staf akademik, staf jo

akademik, qytetar, etj.) trajtohen padrejtësisht për shkak të faktorëve të ndryshëm si: gjinia, raca, etnia, orientimi seksual, aftësitë fizike, feja, ose statusi social si gjendja martesore, dukja fizike, etj.

10.2. **Jo toleranca**- nënkupton mungesë të respektit dhe pranimit të mundësisë të ekzistimit të diversitetit dhe të ndryshimeve mes individëve. Kjo përfshinë çdo formë të sjelljes diskriminuese, përjashtuese ose fyese ndaj pjesëtarëve të komunitetit përfshirë studentët, stafit akademik, apo stafit jo akademik, bazuar në faktorë si raca, gjinia, orientimi seksual, etnia, besimi fetar, apo ndonjë karakteristikë tjetër.

10.3. **Shqetësimi** - i referohet ndjenjës së pasigurisë, frikës, stresit ose pakënaqësisë që mund të përjetojnë studentët, stafi akademik apo stafi jo akademik për shkak të faktorëve të ndryshëm, si pasojë e ngarkesës së lartë në punën akademike, nën presionin për të arritur rezultate të larta, ndjenjës së pasigurisë në lidhje me mundësitë e zhvillimit të karrierës pas diplomimit, ose shqetësimi për mundësin e punësimit në tregun e punës, etj.

10.4 **Ngacmimi**- i referohet çdo forme të sjelljes së papërshtatshme, të paautorizuar dhe të dëmshme që ka për qëllim të bëjë individë ose grup tjetër social të ndihen të pasigurtë, të nënvlerësuar, të frikësuar ose të dëmtuar emocionalisht, përfshirë ngacmimin, ngacmimin seksual, komentet fyese, talljet, shantazhet, prekjet të pavullnetshme, kërcënimet ose përbuzjet, që mund të ndodhin nga studentë, stafi akademik ose stafi tjetër jo akademik.

10.5 **Paragjykimi** - i referohet formimit të mendimeve, qëndrimeve ose opinionëve negative dhe të pamotivuara ndaj individëve ose grupeve të caktuara, bazuar në karakteristika si raca, gjinia, etnia, orientimi seksual, besimi fetar, apo ndonjë faktor tjetër. Paragjykimi shpeshherë shfaqet në formën e stereotipive të ndryshme dhe ndikon në mënyrën se si perceptohen ose trajtohen studentët, stafi akademik ose stafi jo akademik.

## Neni 11

### Vlerat themelore etike në Kolegjin Dardania

Vlerat themelore të Kolegjit Dardania janë: përsosmëria, ndershmëria, autonomia, liria në mësimdhënie dhe në hulumtime shkencore, respektimi i integritetit personal, humanizimi i raporteve ndër njerëzore, drejtësia, barazia dhe e vërteta si vlerë më e lartë.

Stafi akademik, studentët dhe administrata për shërbime studentore janë të përkushtuar që me sinqeritet dhe me përgjegjshmëri të jetësojnë vlerat etike, duke demonstruar qëndrim të drejtë, mendim kritik dhe tolerancë në përditshmërinë praktike në përmbushjen e detyrave të punës për të mundësuar kështu ruajtjen e integritetit të tyre personal dhe kolektiv.

Stafit akademik dhe hulumtuesit në Kolegjin Dardania ushtrojnë qëndrim të përgjegjshëm në punë përmes angazhimit të pakursyer në mësimdhënie, në hulumtime shkencore dhe në punë praktike, dhe rezultatet e tyre të punës iu mundësojnë zhvillimin të vazhdueshëm profesional dhe avancim në karrierë.

Një qëndrim i përgjegjshëm ndaj punës nga ana e tërë komunitetit të Kolegjit Dardania demonstrohet me përmbushjen e plotë dhe të rregullt të detyrimeve të punës.

Pjesëtarët e komunitetit të Kolegjit Dardania nuk hezitojnë që, sipas nevojës, me vetiniciativë, me sinqeritet dhe me profesionalizëm të lartë të angazhohen aktivisht në realizimin e detyrave tjera të punës në kolegji.

#### **Neni 12**

Vlerë tjetër me rëndësi e tërë stafit akademik, e hulumtuesve dhe studentëve është pavarësia intelektuale, që mundëson qëndrim kritik e konstruktiv në refuzimin ndaj çdo apriorizmi në veprimtarinë profesionale dhe në hulumtime shkencore.

Kodi i etikës i obligon të gjithë aktorët e brendshëm (stafin akademik, studentët dhe stafin administrativ) të veprojnë në përputhje me standardet e sjelljes etike duke promovuar standarde të larta akademike dhe profesionale dhe duke iu shmangur çfarëdo konfliktit të interesit në kryerjen e detyrave në përditshmërinë praktike.

#### **Neni 13**

Hapja ndaj ideve të reja është themeli i krijimtarisë shkencore dhe një nga virtytet kyçe të mësimdhënies dhe nxënies. Kritika konstruktive konsiston në pranimin e përgjegjshëm të ideve të reja, të cilat sigurojnë nivel të lartë të cilësisë duke parandaluar thjeshtëzimin dhe ekstremizmin.

#### **Neni 14**

Toleranca nga ana e komunitetit të Kolegjit Dardania mundëson pranimin e diversitetit. Respekt për idetë, qëndrimet dhe mënyrat e jetesës së njerëzve të tjerë. Të jesh tolerant do të thotë të jesh i vetëdijshëm për dallimet në raport me veten dhe t'i pranosh ato në jetën e përditshme.

#### **Neni 15**

Besnikëria e komunitetit të Kolegjit Dardania shprehet në angazhimin e përgjithshëm për ruajtjen e vlerave të arritura në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe në përfaqësimin publik të Kolegjit Dardania.

### **I. MËSIMDHËNIA, TE DREJTAT E PERSONELIT TE KOLEGJIT DARDANIA**

#### **Neni 16**

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Statutit të Kolegjit Dardania të drejtat e personelit akademik të Kolegjit si pjesëtarë të një institucioni të arsimit të lartë, organizohen,

bashkëkohësohen dhe mbikëqyret në mënyrë permanente nga organet qeverisëse të Kolegjit. Kjo bëhet me qëllim që të mbrohet dhe të inkurajohet personeli akademik për mësimdhënie cilësore, për zhvillim të vazhdueshëm profesional, për produktivitet në hulumtime shkencore si dhe të sensibilizohet për përcjelljen e ndryshimeve dhe të risive në shërbimin.

Në këtë aspekt, personeli akademik i Kolegjit ka të drejta të garantuara me legjislacionin e zbatueshëm, me Statutin e Kolegjit dhe me Kodin Etik, si në vijim:

- a) Lirinë akademike,
- b) Të drejtën e shprehjes së lirë,
- c) Të drejtën e mbështetjes nga Kolegji në qoftë se ndonjë anëtar i personelit akademik ndodhet në pozitë të pafavorshme dhe diskriminuese për shkak të respektimit të parimeve etike të këtij kodi;
- d) Të drejtën për t'u gjykuar nga kolegët në pajtim me procedurat dhe procesin e rregullt sipas Kodit të etikes;
- e) Të drejtën e ngritjes në detyrë mbi bazën e kualifikimit personal, kontributit arsimor e shkencor si dhe të demonstrimit të sjelljes etike.
- f) Të drejtën për të ofruar prova, dëshmi dhe fakte në procedurë që mund të zhvillohet nga Këshilli i Etikës.
- g) Të drejta të tjera që parashihen me kontratën e punës.

#### **Neni 17**

Sipas përcaktimeve të Kolegjit Dardania dhe të njërive të veta akademike, mësimdhënia dhe hulumtimi janë detyrim për tërë personelin akademik. Kontributi shkencor dhe performanca profesionale e stafi akademik përcillet dhe vlerësohet rregullisht nga organet e Kolegjit Dardania.

#### **Neni 18**

Anëtarët e stafit akademik ushtrojnë lirinë e tyre akademike përmes mësimdhënies bashkëkohore, gjetjeve empirike, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve tjera kreative të cilat janë në përputhje me standardet etike të pranuarra përgjithësisht.

#### **Neni 19**

Anëtarët e komunitetit të Kolegjit Dardania përbëjnë një tërësi të pandashme që kanë gatishmëri dhe përkushtim për punën e tyre. Qëllimi i mësimdhënies dhe nxënies nga ana e stafit akademik është përhapja e njohurive, nxitja e mendimit kreativ, kritik dhe të përgjegjshëm.

#### **Neni 20**

**PUNA ME STUDENTË, PARIMET ETIKE DHE SJELLJET E JOETIKE**

Kolegji Dardania promovon standarde të larta akademike dhe profesionale. Nga studentët pritet që përherë të shprehin qëndrim të drejtë ndaj punës dhe aktiviteteve mësimore, të sillen në mënyrë etike, veçanërisht gjatë orëve të mësimit, kur paraqesin punën e tyre për vlerësim si dhe gjatë provimeve.

Personeli akademik i Kolegjit Dardania e inkurajon ndjekjen e lirë të ligjëratave, të ushtrimeve dhe ushtrimeve praktike nga studentët e tyre. Stafi akademik shprehë respekt për studentin si individë dhe për studentët si grup bashkësi sociale përmes realizimit profesional dhe me përkushtim rolit të tyre si prijës dhe si udhërrëfyes intelektual dhe mentorial të tyre.

Studentëve iu kërkohet që të respektojnë të gjitha normat që janë të definuar me Kodin e Etikës, në të cilin specifikohen të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve. Veçmas duhet kujdes sjelljes akademike. Studentët duhet t'i kenë parasysh pasojat e veprimeve të mundshme jo etike, sikurse janë: plagjiatura, kopjimi në provime, prirja për të përfaqësuar një person tjetër në provime, falsifikimi i të dhënave në punime seminari, komunikimi i paautorizuar gjatë provimeve, angazhimi i një personi tjetër për të përfaqësuar punën e dikujt tjetër etj.

Studentet duhet të shfrytëzojnë me kujdes resurset materiale, tekstet mësimore, pajisjet kompjuterike në Kolegj.

Puna me studentë, mësimdhënia akademike, hulumtimi dhe aftësimi praktik përmbajnë shtyllat kryesore të jetës dhe punës akademike të Kolegjit Dardania. Këto janë përcaktuar me Statutin e Kolegjit, me rregulloret përkatëse dhe obligimet janë specifikuar edhe me kontratën e studentit. Mos përmbushja e kërkesave paraprake konsiderohet papërgjegjësi e cilitdo anëtarë të komunitetit Dardania, e cila mund të shprehet si:

- a) refuzim arbitrar i qasjes në mësim,
- b) dështim pa arsye madhore që gjatë mësimdhënies, t'u përmbahet rregullave të njësisë akademike përfshirë ligjëratat, ushtrimet e seminarët;
- c) mospjesëmarrje e njëpasnjëshme aktive në aktivitetet mësimore;
- d) mos mbajtje e provimeve sipas orarit të shpallur;
- e) mos mbajtje e konsultimeve sipas orarit;
- f) vlerësimi i punës së studentit sipas kriterëve që nuk reflektojnë objektivitet në kushtet dhe kriteret që ata mbajnë,
- g) mos vlerësimi në vazhdimësi i aktiviteteve sipas ecurisë “çfarë studenti di, çfarë studenti thotë dhe çfarë studenti bënë” si rezultat i reflektimit të përmbajtjeve kurrikulare,
- h) vonimi i publikimit të rezultateve të provimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të punës së studentit;
- i) manipulimi dhe falsifikimi i punës së studentëve,
- j) evitimi i nepotizmit në vlerësimet e studentëve me të cilët anëtari i personelit akademik është në konflikt interesi (vëlla-motër, burrë-grua, fëmijë-prindër, dhe anasjelltas).

### **Neni 21**

Me Kodin Etik të Kolegjit Dardania studentët gëzojnë lirinë akademike që nënkupton autonomi në arritjen e qëllimeve të tyre përmes studimit të përgjegjshëm dhe iniciativës personale si dhe miratimit të sjelljes etike në përputhje me standardet përgjithësisht të pranuara.

### **Neni 22**

Studentëve iu sigurojnë mjedis inkurajues në të nxënë, në punë praktike dhe në hulumtime. Studentët kontribuojnë në rrjedhën normale të procesit mësimor përmes angazhimit dhe punës së tyre të përgjegjshme që ndikon në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor.

### **Neni 23**

Personeli akademik respekton parakushtet e një raporti konfidencial midis mësimdhënësit dhe studentit duke iu shmangur çdo lloj shfrytëzimi, ngacmimi, trajtimi diskriminues, shkeljeje të të drejtës apo nëpërkëmbjes të dinjitetit të tyre.

### **Neni 24**

Diskriminimi i studentit duke përfshirë ngacmimet në baza politike ose dallimet për shkak të racës, ngjyrës, përkatësisë fetare; përkatësisë gjinore, orientimit seksual, bindjeve personale, origjinës etnike, prejardhjes mjedisore, statutit martesor, shtatzënisë, paaftësisë fizike ose mendore, etj. përbën shkelje të Kodit Etik.

Keqpërdorimi i pozicionit apo kompetencave nga anëtari i stafit për të gjykuar me apo pavetëdije sjelljen, veprimin apo mosveprimin e studentit për t'i shkarkuar dëm atij për arsye arbitrare ose personale përbën veprim të ndaluar.

## **II. HULUMTIMET**

### **Neni 25**

Aktivitetet kërkimore shkencore bazohen në lirinë e hulumtimit të udhëhequr me profesionalizëm e ndershmëri në kërkime dhe në ruajtjen e integritetit personal, integritetit akademik dhe atij institucional.

### **Neni 26**

Ndershmëria në hulumtime shkencore përfshinë respektimin e vazhdueshëm të autorësisë, të njohjes së saktë të arritjeve kërkimore shkencore të studiuesve të tjerë, me citim të përgjegjshëm dhe me konsekuencë sipas kërkesave të metodologjisë së punës shkencore.

Në hulumtimin shkencor aplikohen metoda të përshtatshme të hulumtimit të cilat mundësojnë një shqyrtim objektiv të hipotezave kërkimore, përpunim statistikor të dhënave dhe interpretim profesional e objektiv të rezultateve të hulumtimit.

#### Neni 27

Hulumtuesit e Kolegjit Dardania, përveç rregulloreve në fuqi, i përmbahen edhe rregullave dhe standardeve etike, të pranuar ndërkombëtarisht të cilat zbatohen në fusha specifike të hulumtimit shkencor.

### III - Plagjiatura

#### Neni 28

Personali akademik i Kolegjit Dardania duhet të jetë në nivel të detyrës dhe të kompetencës së tij etike dhe profesionale në punën e tij hulumtuese – shkencore, duke iu shmangë çfarëdo lloji plagjiature në punimet e tij me shkrim, në librat dhe në veprimtarinë e tij hulumtuese-shkencore.

#### Neni 29

Me këtë Kod etik është e dënueshme plagjiatura e çdo lloji. Kësisoj, format e dënueshme të plagjiaturës janë:

- plagjiatura aksidentale;
- plagjiatura e pa qëllimshme;
- plagjiatura e qëllimshme;
- auto plagjiatura.

**Plagjiatura aksidentale** ndodhë në rastet kur një person përdorë materiale të tjera (p.sh. ide, fraza, paragrafë ose pjesë të tekstit) pa i cituar ato si duhet, pa pasur qëllim të keq ose pa pasur qëllim për të mashtruar. Kjo mund të ndodhë për shkak të neglizhencës, mungesës së njohurive mbi rregullat e citimit ose thjesht, për shkak të ngarkesës dhe presionit për të përfunduar detyrën sa më parë.

**Plagjiaturë e paqëllimshme**, konsiderohet çdo parafrazim i pa kujdesshëm, mos shënim i fusnotës apo mos evidentim i saktë i burimit të shfrytëzuar, pa i respektuar rekomandimet e metodologjisë bashkëkohore të punës kërkimore shkencore.

**Plagjiaturë e qëllimshme** konsiderohet çdo veprim kopjimi, ngjitje e teksteve (kompilacioni) nga materiale fizike, burime online apo tekste të formuara nga chat-gpt, duke mos iu përmbajtur fare standardeve të metodologjisë kërkimore-shkencore e që mund të konsiderohet “huazimi” i materialit pa leje të autorit!

**Auto plagjiaturë** konsiderohet veprimi kur autori - pjesë e personelit akademik, në krijimtarinë e tij shkencore hulumtuese “harron” ose injoron “pa qëllim” citimin e burimeve të tij të botuara me herët, ose duke i modifikuar ato fare pak!

### Neni 30

## TRAJNIMI MBI KODIN ETIK

Kolegji Dardania organizon trajnime mbi etikën akademike për stafin akademik, studentët dhe stafin administrativ. Kolegji Dardania trajnimet i organizon me qëllim të informimit me të hollësishëm të komunitetit (mësimdhënës, administratë, studentë, alumnin dhe përfaqësues të punëdhënësve) mbi dispozitat e Kodit të Etikës dhe detyrimet e anëtarëve të komunitetit për zbatimin praktik të dispozitave të këtij Kodi.

Trajnimet janë obligative për tërë stafin e posaçërisht janë të detyrueshëm për personelin e ri i cili është pranuar në marrëdhënie pune apo janë të angazhuar në çfarëdo forme në veprimtarinë e gjithëmbarshme të Kolegjit Dardania.

## IV. AKTIVITETET DHE SJELLJA E ANËTARËVE TË KOMUNITETIT JASHTË MJEDISIT TË KOLEGJIT DARDANIA

### Neni 31

Anëtarët e komunitetit të cilët veprojnë jashtë Kolegjit Dardania si persona privat, duhet t’i respektojnë vlerat dhe standardet etike siç përcaktohen me Kodin Etik të Kolegjit Dardania.

Anëtarët e komunitetit të Kolegjit kanë të drejtë të bashkohen me shoqatat profesionale, partitë politike, bashkësi fetare dhe organizata të tjera si persona privat. Mirëpo, këta persona privat në aktivitetet e tyre duhet t’i shmangen konfliktit të interesit duke mos rënë ndesh me përgjegjësitë dhe detyrat e tyre në Kolegji.

### Neni 32

Konflikt interesi konsiderohet çdo veprim që prodhon një situatë konflikti bazuar në Ligjim për Arsimin e lart, Statutin e Kolegjit dhe kontratën e punës. Në këtë aspekt, ndalohej çdo veprim i cili prodhon situatë të *nepotizmit*, bazuar në raportet familjare qoftë në vijë të drejt qoftë në vijë të tërthortë, si në rastet: prind-birë/bijë; vëlla/motër; motër/vëlla; dajë/mbesë; nip/dajë, etj.

Secili veprim i bazuar në rrethana të konfliktit të interesit, për organet e Kolegjit Dardania, konsiderohet i pavlefshëm dhe në kundërshtim me këtë Kod Etik.

### **Neni 33**

Anëtarët e komunitetit të Kolegjit Dardania: stafi akademik, studentët, stafi administrativ të cilët janë të emëruar si përfaqësues të një partie politike nuk mund të zgjidhen apo të emërohen në ndonjë pozitë drejtuese brenda Kolegjit Dardania.

Aktiviteti politik ose ndonjë formë tjetër e propagandës në mjediset e Kolegjit Dardania nëse përdoret si mjet i shfrytëzimit në proces të mësimdhënies, paraqesin shkelje serioze të Kodit Etik.

## **V. VEPRIMTARIA JASHTË KOLEGJIT**

### **Neni 34**

Anëtarët e komunitetit të Kolegjit Dardania nuk mund të kryejnë aktivitete jashtë institucionit nëse ato e pengojnë rrjedhën normale të procesit të mësimdhënies, të hulumtimeve ose të punës administrative.

### **Neni 35**

Anëtarët e komunitetit të Kolegjit kur përfshihen në aktivitete të tjera jashtë tij, duhet t'i përmbahen Kodit Etik, vlerave themelore dhe rregullave të tij veçmas kur bëhet fjalë për ndershmërinë, qëndrimin kritik dhe dinjitetin profesional dhe akademik.

## **VI. SJELLJA NDAJ BURIMEVE TË KOLEGJIT DARDANIA**

### **Neni 36**

Të gjithë anëtarët e komunitetit (stafi akademik, studentët, stafi administrativ, dhe punëtorët teknik) gjatë shfrytëzimit të hapësirave të objektit, të pajisjeve dhe mjeteve financiare, të cilat janë destinuar për qëllime të caktuara, duhet të tregohen të kujdesshëm, t'i përdorin ekonomikisht sepse ato janë në dobi të përfitimit për komunitetin dhe jo për përfitime private.

## **VII. POZITAT ADMINISTRATIVE NË KOLEGJIN DARDANIA**

### **Neni 37**

Anëtarët administrativ të Kolegjit dhe studentët, të cilët mbajnë poste administrative duhet t'u përmbahen standardeve të Kodit Etik të Kolegjit. Punët dhe detyrat e tyre duhet të kryhen në frymën e traditës akademike, me përkushtim dhe përgjegjësi të lartë. Me këtë rast duhet marrë parasysh efektet afatgjata të masave që ata i propozojnë dhe prezantojnë, duhet arritur konsensus në vendimmarrje për të iu shmangur mbivotimit.

## **VII. KËSHILLI I ETIKËS**

### **Neni 38**

#### **Mandati i Këshillit të Etikës**

Këshilli i Etikës i Kolegjit Dardania ka një strukturë të qëndrueshme me përgjegjësi për analizën dhe zgjidhjen e çdo shkeljeje të mundshme të Kodit Etik.

Këshillin e Etikës e zgjedh Senati i Kolegjit Dardania me propozimin e Rektorit. Këshilli Drejtues i Kolegjit me propozim të Senatit, emëron Këshillin e Etikës dhe përcakton anëtarët, kohëzgjatjen e shërbimit dhe përgjegjësitë e tij. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Etikës është me kohëzgjatje katër vjeçare me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat të dytë. Mbledhjen konstituive të Këshillit të Etikës e thërret anëtari më i vjetër. Në mbledhjen e parë të Këshillit të Etikës zgjedhet kryetari dhe nënkryetari me votim të fshehtë.

### **Neni 39**

#### **Përbërja**

Këshillin e Etikës e përbëjnë pesë (5) anëtarë, tre nga të cilët janë pjesëtare të gjinisë femërore dhe dy të gjinisë mashkullore. Së paku njëri nga anëtarët e Këshillit të Etikës duhet të jetë nga fusha e drejtësisë.

### **Neni 40**

#### **Humbja e Statusit të Anëtarit të Këshillit të Etikës**

Humbja e Statusit të anëtarit të Këshillit të Etikës bëhet në rastet si vijon:

- kur anëtari bëhet vet objekt i trajtimit për veprim ose mos veprim në përputhje me Kodin e Etikës;
- në qoftëse nuk merr pjesë në tre mbledhje të njëpasnjëshme pa ndonjë arsytim paraprak;
- në qoftë se pensionohet apo për shkak të paaftësisë fizike apo psikike;
- në rast vdekje.

### **Neni 41**

#### **Puna e Këshillit të Etikës**

Puna e Këshillit të Etikës bazohet në *Rregulloren për masat dhe procedurën disiplinore të personelit në Kolegj dhe Rregulloren për masat dhe procedurën disiplinore dhe përgjegjësinë e studentëve në Kolegj*, si dhe në normat e shkruara në Kodin Etik, në Statutin e Kolegjit

Dardania, në normat e përcaktuara me Kontratën e punës dhe në Ligjin për Themelimin e Marrëdhënies së Punës. Këshilli i Etikës zbaton legjislacionin e aplikueshëm në fuqi në Republikën e Kosovës.

## Neni 42

Procedurat për Trajtimin e Sjelljeve Jo Etike

Kolegji Dardania garanton një proces të drejtë, profesional dhe konfidencial për trajtimin e sjelljeve që bien ndesh me parimet etike:

### **Raportimi**

Çdo anëtar i komunitetit akademik ka të drejtë dhe përgjegjësi të raportojë sjellje të dyshimta;

Raportimi mund të bëhet te Komisioni për Çështje Etike, eprori përkatës ose përmes emailit institucional: [sinjalizo@kolegjidardania.com](mailto:sinjalizo@kolegjidardania.com)

Lejohen raportime anonime, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

### **Verifikimi Paraprak**

Komisioni për Çështje Etike shqyrton vlefshmërinë e raportimit;

Rastet më të ndërlikuara referohen Komisionit Qendror për Etikë.

### **Hetimi dhe Vlerësimi**

Realizohet hetim i brendshëm me përfshirjen e palëve;

Respektohet konfidencialiteti dhe dinjteti i të gjitha palëve të përfshira.

### **Vendimmarrja**

Komisioni përgatit raport përfundimtar dhe propozon masat përkatëse: paralajmërim, qortim, pezullim, ndërprerje marrëdhënie pune/studimi, etj.;

Palët informohen me shkrim për vendimin dhe të drejtën e apelit.

### **Apelimi**

Personi i ndëshkuar ka të drejtë të apelojë brenda afatit të përcaktuar;

Apeli trajtohet nga një trup i pavarur ose nga Komisioni Qendror për Etikë, sipas rregullores së Kolegjit.

## VIII. MASAT DISIPLINORE

### Neni 43

Këshilli i Etikës përkujdeset që stafi akademik, studentët dhe stafi administrativ të cilët kanë shkelur një ose më shumë nga standardet e sjelljes të Kodit Etik, duhet t'iu nënshtrohen masave disiplinore. Masat etike për stafin akademik për shkelje të lehta sipas Kodit Etik, i shqipton Këshilli i Etikës, si shkallë e parë dhe Senati i Kolegjit si shkallë e dytë. Në këtë aspekt, masat që i shqipton Komisioni i ankesave janë:

- 1.1. Vërejtje me gojë,
- 1.2. Vërejtje me shkrim,
- 1.3. Paralajmërim me shkrim për procedimin e rastit në Këshillin e etikës,

Për shkelje të rënda sipas Kodit Etik, Këshilli i etikës propozon njërën nga masat në vijim:

- 2.1. Qortim,
- 2.2. Vërejtje me shkrim për shkelje të rëndë
- 2.3. Suspendim nga puna i personelit akademik gjashtë (6) muaj;
- 2.4. Suspendim nga puna për më shumë se gjashtë (6) muaj deri në dymbëdhjetë (12) muaj.
- 2.5. Ndalim i përfshirjes në çfarëdolloj komisioni vlerësuese deri në periudhën pesë (5) vjeçare.
- 2.6. Ndalim i përfshirjes në tema të diplomës të studimeve themelore, në tezat e diplomës të nivelit master dhe në tezat e doktoratës, deri në 5 vjet.
- 2.7. Ndalim i avancimit dhe rizgjedhjes në gradë më të lartë akademike në periudhën katër (4) vjeçare.
- 2.8. Ulje në pozitë, respektivisht në gradë shkencore,
- 2.9. Heqje e titullit akademik të cilin vendim duhet ta marr organi i cili e ka dhënë titullin ( Senati i Kolegjit),
- 2.10. Largim nga puna.

Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin një (1) të këtij neni, shqiptohen nga Këshilli i Etikës i kolegjit, ndërsa masat disiplinore nga paragrafi 2 të këtij neni do të propozohen nga Këshilli i Etikës së Kolegjit dhe dërgohen për miratim nga Senati, përkatësisht nga Këshilli Drejtues.

Këshilli i Etikës me rastin e shqyrtimit të rasteve të shkeljeve etike bazohet në Rregulloren për masat dhe procedurën disiplinore të personelit dhe përgjegjësinë e studentëve në Kolegj, në normat e shkruara në Kodin e Etikës dhe në harmoni me të i shqipton masat proporcionale bazuar në rrethanat dhe në nivelin e shkeljes etike.

#### **Neni 44**

##### **Mbrojtja e personave të cilët raportojnë shkelje etike**

Kolegji garanton mbrojtjen e personelit akademik dhe të studentëve që raportojnë shkeljet etike duke iu siguruar atyre se nuk do të pësojnë asnjë formë ndëshkimi, hakmarrjeje apo diskriminimi.

#### **Neni 44**

Këshilli i Etikës i emëruar nga Këshilli Drejtues i Kolegjit përkatësisht Senati i kolegjit i rishqyrton ankesat e palëve në vendimin e Këshillit të Etikës.

Këshilli Drejtues i shqyrton edhe ankesat e palëve të tjera të dëmtuara nga propozimet e Këshillit të Etikës në pajtim me Rregulloren për masat dhe procedurën disiplinore të personelit dhe përgjegjësinë e studentëve në Kolegj, Statutin e kolegjit dhe Kontratën e punës të palës ankimore.

#### Neni 45

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Kolegjit Dardania.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues,

Prof. Dr. Halim Gjergjizi

